

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës A.I. nga fsh.P. i J. K F., për shkak të veprës penale, të rrezikimit të trafikut publik ë nga neni 378 par.8-6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr.1048/17 të datës 07.11.2017, në shqyrtimin e fillestar të mbajtur më datë **22.05.2017**, në prani të Prokurorit të shtetit Dëshire Jusaj ,të dëmtuarve – të miturve L. I., A. I. dhe E. I. si dhe të akuzuarës A.I. ,te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **A.I.** nga fsh. P.i J. K F., e lindur me ... në Gj., e bija e D.I. dhe e ëma H. e gjinisë K., ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e gjendjes se dobët ekonomike, shqiptare ,shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë e 4 fëmijëve, me ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

-më dt.26.6.2017, rreth orës 13.55 min. në rrugën regjionale Gj.- K. ,përball pompës se benzinës “N. – S” ,në fsh. Q. ,duke drejtuar automjetin e saj te tipit “....”,me targa regj,ka rrezikuar trafikun publik, pasurin dhe jetën e te dëmtuarve :A.Rr., A. I., E. I. dhe L. I., ashtu qe ka drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin 53,54,56 dhe 120 te Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, edhe pse ka qene e vetëdijshme se me një veprim te tillë do te vije deri te pasoja e ndaluar, lehtas e ka marrë se gjere tek ajo nuk do te vije apo se në momentin e duhur do t'i shmanget ,në atë mënyrë me te arritur në afërsi te pompës se derivateve “N. –S.” ,duke mos iu përmbajtur shpejtësisë së lëvizjes me kushtet dhe rrethanat e rrugës si dhe duke mos mbajtur distancën e sigurisë ,për një moment në tentim te shmangies se aksidentit kalon në shiritin e majtë ku me pjesën e përparme te automjetit godet në pjesën e pasme te anës se majtë automjetin e tipit “....”, me ngjyre hiri, me tar.,të cilin e drejtonte i dëmtuari A. R. i cili në ato momente ishte në përfundim e sipër si dhe të çkyçjes nga rruga kryesore për në te majtë ,me ç rast shkaktohen dëme materiale si dhe dëmtime te renda trupore pëson vajza e saj, e dëmtuara L. I. ,ndërsa te dëmtuarit A. R., A. I. dhe E. I. pësojnë lëndime te lehta gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko –ligjore e dt. N.U. dt.

-me çka ka kryer veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8-6 te KPRK-s

Gjykata në mbështetje të nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 378/8-6 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej **180(njëqind e tetëdhjetë) ditësh**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil .

Detyrohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumen prej **90.88 €** si dhe në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej **30,00 €**, në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1048 të dt.07.11.2017, e ka akuzuar të akuzuarën A. I. nga P. J. K F. , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8-6 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.22.02.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë , Prokurori Dëshire Jusaj , lexoi aktakuzën PP/II.nr.1048/17 të dt.07.11.2017 dhe deklaroi se mbetet ne tersi pranë aktakuzës.

E akuzuara A. I. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe shtoj se me pranimin e fajësisë jam e penduar për veprën e kryer nga pakujdesia , premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem më e kujdesshme me qene se gjatë këtij aksidenti fëmijët e mi kanë pësuar lëndime duke filluar nga i lëndim i rende si dhe lëndime te lehta trupore gjë qe me ka goditur tepër ,ju kërkoj falje para gjykatës për lëndimet e shkaktuara te dëmtuarve , andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysht rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë ,premtimin se në të ardhmen do të jem më e kujdesshme si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

E mitura L. I. ne prezencën e perf. ligjore nenës A.I. lidhur me fajësinë deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndërsa kompensimin e demit do ta realizojë ne kontest civil.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara A.I. : më dt.26.6.2017, rreth orës 13.55 min. në rrugën regjionale Gj. –K. ,përball pompës se benzinës “N. –S” ,në fsh. Q. duke drejtuar automjetin e saj te tipit “B.-3. ”,me targa regj ... ,ka rrezikuar trafikun publik, pasurin dhe jetën e te dëmtuarve :A. Rr. ,A.I. ,E. I. dhe L. I. ,ashtu qe ka drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin 53,54,56 dhe 120 te Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, edhe pse ka qene e vetëdijshme se me një veprim te tillë do te vije deri te pasoja e ndaluar, lehtas e ka marrë se gjere tek ajo nuk do te vije apo se në momentin e duhur do t’i shmanget ,në atë mënyrë me te arritur në afërsi te pompës se derivateve “N. -S” ,duke mos iu përmbajtur shpejtësisë së lëvizjes me kushtet dhe rrethanat e rrugës si dhe duke mos mbajtur distancën e sigurisë ,për një moment në tentim te shmangies se aksidentit kalon në shiritin e majtë ku me pjesën e përparme te automjetit godet në pjesën e pasme te anës se majtë automjetin e tipit “...” , me ngjyre hiri , me tar. regj ... ,të cilin e drejtonte i dëmtuari A. R. i cili në ato momente ishte në përfundim e sipër si dhe të çkqçjes nga rruga kryesore për në te majtë ,me ç’rast shkaktohen dëme materiale si dhe dëmtime te renda trupore pëson vajza e saj , e dëmtuara L.I. ,ndërsa te dëmtuarit A.Rr. ,A. I. dhe E.I. pësojnë lëndime te lehta gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko – ligjore e dt. N.U. dt. 21.08.2017.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarës formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur

qe te akuzuarën ta shpalle fajtores dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarës ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana renduese nuk gjeti ,ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, personalitetin e te akuzuarës si nënë e 4 fëmijëve , pendimin e saj , kërkim faljen nga të dëmtuarit për lëndimet e shkaktuara ku tre nga te dëmtuarit janë fëmijët e saj te mitur, sjelljen korrekte e të akuzuarës ne gjykim, premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më e kujdesshme, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se është hera e parë që bie në ndesh me ligjin. Kështu që duke mos gjetur rrethana renduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh** ,i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ,do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 770/17 më datë 22.02.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatë së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.